



Prishtine, 08.01.2021

Ref. 01/2021

Në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 07/L – 016 për Rimëkëmbjen Ekonomike – Covid – 19 dhe nenin 34 paragrafi 2.2. të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, U.D i Kryesuesit të Bordit të KPMM-së, nxjerr këtë:

## VENDIM PËR LIRIMIN NGA PAGESA E RENTËS MINERARE

1. Lirohen nga pagesa e rentës minerare për periudhën prej datës 1 Janar deri më 31 Maj të gjitha ndërmarrjet që posedojnë Licencë të Shfrytëzimit për resurse minerare.
2. Ndërmarrjet do të lirohen nga pagesa e rentës minerare vetëm për sasinë e planifikuar sipas Projektit të Shfrytëzimit (planifikimi vjetor), e shpërndarë kjo në baza mujore.
3. Në rast se ndërmarrjet tejkalojnë planifikimin, për sasinë e prodhuar më shumë se planifikimi (në baza mujore) do të paguajnë rentë minerare.



Ramiz Krasniqi

Drejtori

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

*Vendimi të publikohet në:*  
Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;  
Webfaqen zyrtare të KPMM-së;

